

Lëvizja RINI AKTIVE



SHOQATA "BARLETI"
Shëndet - Edukim - Sport - Turizëm



UNIVERSITETI
BARLETI



KUSH?

Shoqata "Barleti" në partneritet me
Universitetin Barleti dhe Qendrën Youth Act.

Ku? Në gjithë
Shqipërinë.



PSE KJO INICIATIVË?

Lëvizja RINI AKTIVE synon ngritjen e një programi kombëtar që ve në qendër mirëqënien mendore dhe fizike të nxënësve të arsimit parauniversitar, duke rikthyer vëmendjen e munguar në elementë të tillë si: sporti / aktiviteti fizik, shëndeti, edukimi social dhe argëtimi.

Ne besojmë se fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë duhet të ndihmohen të ndryshojnë qasjen ndaj sportit/aktivitetit fizik, edukimit, argëtimit duke përmirësuar në mënyrë direkte shëndetin dhe cilësinë e jetës së tyre.

Lëvizja do të mbledhë bashkë drejtues dhe mësues të edukimit fizik të insitucioneve arsimore në mbarë vendin, që ndajnë të njëjtin besim dhe që mendojnë se mund të japin një kontribut brenda komuniteteve të tyre lokale.

DREJTIMET KRYESORE TË LËVIZJES "RINI AKTIVE"

Lëvizja RINI AKTIVE

SPORTI

Aktiviteti fizik, ushtrimi i sporteve të ndryshme, orët e edukimit fizik në shkollat e arsimit parauniversitar etj.

1

SHËNDETI

Rëndësia e të ushqyerit të shëndetshëm, shëndeti mendor dhe fizik, shëndetin seksual, abuzimi me supstancat, Covid -19 etj.

2

EDUKIMI

Edukimi qytetar, të drejtat, media, mjedisi dhe kujdesi për të, aftësi sociale etj.

3

ARGËTIMI

Pasurimi dhe riorganizimi i kohës së lirë, organizimi i turneve dhe kampionateve sportive, aktiviteve rekreative etj.

4





SHOQATA "BARLETI"
Shëndet - Edukim - Sport - Turizëm



UNIVERSITETI
BARLETI



Rezultatet e pritshme



- Rritja e ndërgjegjësismit të fëmijëve dhe të rinjve mbi rëndësinë e aktivitetit fizik në shëndetin e çdo individi.
- Përfshirja e sa shumë fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete lëvizore e sportive.
- Rritja e kapacitetit të drejtuesve dhe mësuesve të edukimit fizik të Institucioneve arsimore parauniversitare në mbarë vendin mbi risitë dhe programet bashkëkohore për një edukim fizik gjithëpërfshirës.
- Pasurimin e kohës së lirë të fëmijëve dhe të rinjve me aktivitete të shëndetshme, argëtuese dhe edukative.
- Përmirësimi i programeve mësimore edukative për nxënësit e shkollave të arsimit parauniversitar.
- Organizimin e aktiviteteve sportive, turneve, kampionateve apo aktiviteteve rekreative periodike në nivel lokal apo kombëtar.
- Ngritja e Shoqatave Sportive të shkollave fillore dhe të mesme të Shqipërisë, si stuktura shtesë në mbështetje të Institucioneve arsimore për realizimin dhe konsolidimin e kësaj lëvizjeje në të ardhmen.





SHOQATA "BARLETI"

Shëndet - Edukim - Sport - Turizëm



UNIVERSITETI
BARLETI



Lëvizja
RINI AKTIVE

MANIFEST

Ne besojmë se fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë duhet të ndihmohen të ndryshojnë qasjen ndaj sportit/ aktivitetit fizik, edukimit, argëtimit duke përmirësuar në mënyrë direkte shëndetin dhe cilësinë e jetës së tyre.

RINI AKTIVE sepse aktiviteti fizik është i rëndësishëm për të gjitha moshat, në mënyrë të veçantë sjell përfitime të dukshme për rritjen dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve dhe të rinjve.

RINI AKTIVE për ti dhënë sportit dhe aktivitetit fizik vëmendjen e munguar, për ta bërë gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm për të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar.

RINI AKTIVE për të përmirësuar shëndetin dhe mënyrën e jetesës së fëmijëve dhe të rinjve.

RINI AKTIVE për edukim social të vazhueshëm, në përputhje me moshën dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve.

RINI AKTIVE për një të ardhme me fokus tek sporti, edukimi, shëndeti dhe argëtimi!

RINI AKTIVE për një shoqëri aktive !

Nëse ndani të njëjtin besim me ne dhe mendoni se mund të jepni një kontribut brenda komuniteteve tuaja lokale ju ftojmë të firmosni manifestin RINI AKTIVE.



BASHKOHET ME LËVIZJEN RINI AKTIVE:

EMËR MBIEMËR/ MËSUES I EDUKIMIT FIZIK

INSTITUCIONI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ADRESË EMAILI/ NUMËR TELEFONI

Adresa: Rr. Frank Bardhi, Nr. 18
E-mail: director@shoqatabarleti.al
info@shoqatabarleti.al
Tel: +355 69 20 91 775

#SPORT

#SHËNDET

#EDUKIM

#ARGËTIM